# Buletini i Njoftimeve Zyrtare
# I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2018 – Numri: 33

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 27 gusht 2018**


## PËRMBAJTJA

Faqe


| | | |
|---|---|---|
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1409, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Elton Xhameta, NIPT L51321021Q." | 3 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1410, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Z. Rasim Koçi" | 5 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1411, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Gega sh.p.k." | 5 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1412, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Z. Hajdin Çuni" | 8 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1413, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Elfa Recycling sh.p.k." | 8 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1414, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Z. Ferit Koka" | 9 |

| | | |
|---|---|---|
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1415, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "1.Albano Hysenaj nr. NIPT L52125099 H"................................................ | 10 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1416, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "1. A.K. sh.p.k."........................................................................................................ | 12 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 1417, datë 16.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "1. N.E.A-08 nr. NIPT K8181801 N"........................................................ | 13 |
| Kërkesë e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit nr. 4270, datë 17.8.2018 | Për botimin e vendimit për dënim administrativ, ndaj subjektit "Frenki" sh.p.k."........................................................................................................ | 15 |
| Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr.10595/1, datë 20.8.2018 | Ftesë për ofertë për procesin konkurrues "Për përzgjedhjen e projektit që do të përfitojë masat mbështetëse për ndërtimin e impiantit fotovoltaik në zonën e Akërnisë (Vlorë)....................................................................................... | 16 |
| Njoftim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 717, datë 23.8.2018 | Për shitje me ankand të pronës shtetërore në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, të Ministrisë së Brendshme, të Ministrisë së Mbrojtjes, të Ndërmarrjes Industriale nr. 1, si dhe të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.. | 19 |
| Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/11, datë 23.8.2018 | Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës "Hartimi i metodologjive dhe trajnimi i stafit për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një profili të rrezikut (përfshirë procedurat ndërkontrolluese) për NE-në"....................................................................... | 22 |
| Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/12, datë 23.8.2018 | Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës "Sondazh i familjeve për vlerësimin e ndikimeve të reformës së NE-së"...................................... | 23 |
| Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 897/13, datë 23.8.2018 | Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës "Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i stafit të vlerësimit të PAK, mjekëve specialistë dhe mjekëve të familjes, administratorëve socialë të Bashkisë Tiranë në zbatimin e reformave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar"........ | 25 |

**KËRKESË**
**Nr. 1409, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "ELTON XHAMETA, NIPT L51321021Q"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

Elton Xhameta, NIPT L51321021Q.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

Nr. Serial: 0000291

**VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT**
**Nr. 6, datë 18.07.2018**

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Elton Xhameta", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës "16", të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për lejet e Mjedisit, i ndryshuar", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0001838, datë 11/07/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

1. Të dënoj me **Gjobë** në vlerën : 300 000 **lekë** ( Treqind mijë Lekë )
2. Të dënoj me " **Paralajmërim** ", si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: ..........
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme: ..........
5. Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi ________, datë ___/___/___
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ___.___.___
7. Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën ........ lekë (..........)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

**INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU**

1. Dropes Mehmetaj; ID ________; ( [signature] )
2. Kejdi Ahmetaj; ID ________; ( [signature] )
3. ________; ID ________; ( )

( Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi )

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

**Nr. Serial:** 0001838 Datë: 11/07/2018

## PROÇES - VERBALI I INSPEKTIMIT

Në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", të ndryshuar, në kontrollin e ushtruar në subjektin:

Elton Xhameta

**NIPT:** L51321021 B

**Aktiviteti dhe adresa e subjektit:** Riparim i pajisjeve motorike
Q. Tiranë B. Tiranë, Nj. A. Kashar Lagjia Kashar

në prani të: — , me detyrë

Konstatova: Subjekti është mbajtës i një leje administrative: Po→ ☒ Jo→ ☐ ;

Tipi i Lejes Mjedisore C, Nr. Identifikimit 229, datë 04/06/2015.

PËRSHKRIMI, GJETJET DHE SHKELJET ADMINISTRATIVE:

Në bazë të proces-verbalit të inspektimit nr. 0000327 dt. 25/06/2018 dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar në ISHMPU Tiranë me Nr. 1240 Prot. dt. 06/07/2018 rezultoi se subjekti ka kryer raport të vetmonitorimave për periudhën dhjetor-maj dhe të dorëzuar në DRM Tiranë me Nr. 1280 Prot. dt. 6/7/2018. Subjekti nuk zbaton pikat 6.2.8.6.3 të Kushtit 6 pikën 4.1.6 të lejes mjedisore. Zbatimi pikës 4.1.6 nuk është brenda afateve ligjor. Në bazë germës b), pika 1, neni 24, Ligji 10448 Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar, këto shkelje ligjore përbëjnë kundërvajtje administrative

**Personi përgjegjës i kontrolluar**
u Plotësua në zyrë pas verifikimit
(Emër, mbiemër, firmë)
të dosjes të dorëzuar në protokoll në institucionit.

**Specialisti**
(Emër, mbiemër, firmë)

**Inspektori i ISHMPU**
Klajdi Ahmeta
Kujtim Mehmeti
(Emër, mbiemër, firmë)

- Akti inspektimit mbahet në 4 (katër) kopje dhe sipas qëllimit të inspektimit përdoret:

1. Për kontrollin e përputhshmërisë. ☐
2. Për verifikimin e zbatimit së detyrave të lëna. ☒
3. Për inspektim të rastësishëm. ☐
4. Për rast incidenti ose aksidenti. ☐

- Për përshkrime të detajuara, aktit të inspektimit i bashkëlidhet një aneks shtesë A-4, si pjesë e tij.

**KËRKESË**
**Nr. 1410, datë 16.8.2018**

## PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "Z. RASIM KOÇI"

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

Z. Rasim Koçi

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**VENDIM**
**Nr. 3457, datë 9.7.2018**

## I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, "Për krijimin dhe mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve", i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 14, datë 25.11.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik "Rasim Koçi", protokolluar me nr. 43 prot., datë 8.1.2018.

KOMISIONI:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyetojmë se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me germën "rr" të pikës të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë nga ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë,

VENDOSI:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 14, datë 25.11.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 10.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit "Rasim Koçi" ndaj këtij dënimi administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR NË DETYRË
**Armando Lamaj**

**KËRKESË**
**Nr. 1411, datë 16.8.2018**

## PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "GEGA SHPK"

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. Gega sh.p.k.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE**

**Nr. Serial:** 0000414

## VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

**Nr.** 09 **, datë** 31.05.2018

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit ~~fizik~~/juridik, " GEGA SH.P.K Nipt: K02210002R

në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 6, të nenit 62, të ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011, " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve (i ndryshuar)",

referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0000259, datë 18.05.2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

**1.** Të dënoj me **Gjobë** në vlerën : 1 500 000 **lekë** ( Një milion e pesëqind mijë )

**2.** Të dënoj me **" Paralajmërim "**, si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

**3.** Të pezullojë ~~pjesërisht ose~~ plotësisht aktivitetin: Deri në pajisje me dokumentacion mjedisor përkatës.

**4.** Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme: ........................................

**5.** Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi ______________, datë ____/____/______

**6.** Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ____.____.____

**7.** Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën .................... lekë (........................................)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

**INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU**

1. Genci Hicka ; ID 0301020016 ; ( [signature] )
2. Kejdi Ahmetaj ; ID J10410076I ; ( [signature] )
3. ______________ ; ID ______________ ; ( )

( Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi )

REPUBLIK[illegible] E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TU[illegible]ZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR [illegible] MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

**Nr. Serial:** 0000279    Datë: 18.05.201

**PROÇES - VERB[illegible] I I[illegible]SPEKTIMIT**

Në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 1043[illegible] [illegible] 16.[illegible]6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit [illegible] [illegible]istra[illegible] nr. 103, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të [illegible] [illegible]torat Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", të ndryshuar, në kontrollin e ushtruar në subj[illegible]kt

............................................................................
GEG[illegible] [illegible]
.................................... NIPT: K02210002R

**Aktiviteti dhe adresa e subjektit:** Tran[illegible] [illegible] i [illegible] inerte (D[illegible]) [illegible] [illegible] [illegible] [illegible], Kamëz

në prani të: Armando Xhepa me [illegible]tyrë shofer
ID: J00613048A

Konstatova: Subjekti është mbajtës i një leje adm[illegible]strati[illegible]e: Po→ ☐ Jo→ ☒

Tipi i Lejes Mjedisore ___, Nr. Identifiki[illegible] ___, datë __/__/__.

PËRSHKRIMI, G[illegible]TJE[illegible] [illegible] [illegible]KE[illegible]ET ADMINISTRATIVE:

Bazuar në Autorizimin e Inspe[illegible] [illegible] me nr 581 prot. dt. 10.05.201 u kontrollua dokume[illegible] [illegible] i mjetit tip kamion me targë TR 9619 R i cili p[illegible] [illegible] të transport të mbetjeve inerte të llojit D[illegible]. Në mom[illegible] [illegible] kontrollit nuk u vu në dispozicion (dokumentacion) mjedisor për [illegible] [illegible]) për kryerjen e këtij lloji aktiviteti. Për [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] [illegible] detyrë të paraqesë dokumentacionin [illegible] [illegible] pranë ISHMPU Tiranë brenda 2(dy) dit

| **Personi përgjegjës i kontrolluar** | **Specia[illegible]** | **Inspektori i ISHMPU** |
|---|---|---|
| ............ | ............ | [signature] |
| ............ | ............ | [signature] |
| (Emër, mbiemër, firmë) | (Emër, m[illegible] [illegible], firmë) | ( Emër, mbiemër, firmë ) |

- Akti inspektimit mbahet në 4 (katër) kopje dhe si[illegible] [illegible]llimit [illegible] inspektimit përdoret:

1. Për kontrollin e përputhshmërisë. ☐
2. Për verifikimin e zbatimit së detyrave të lëna.
3. Për inspektim të rastësishëm. ☒
4. Për rast incidenti ose aksidenti. ☐

- Për përshkrime të detajuara, aktit të inspektimi[illegible] [illegible]shkë[illegible]dhet një aneks shtesë A-4, si pjesë e tij.

**KËRKESË**
**Nr. 1412, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "Z. HAJDIN ÇUNI"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

Z. Hajdin Çuni

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**VENDIM**
**Nr. 3460, datë 9.7.2018**

**I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, "Për krijimin dhe mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve", i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 1, datë 6.4.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik "Hajdin Çuni", protokolluar me nr. 1557 prot., datë 12.4.2018.

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyetojmë se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me nenin 2, të ligjit nr. 5/2016, "Për Shpalljen e Moratoriumit të Pyjeve në Republikën e Shqipërisë".

Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë nga ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë,

VENDOSI:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë",

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 1, datë 6.4.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 5.000.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit "Hajdin Çuni" ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR NË DETYRË
**Armando Lamaj**

**KËRKESË**
**Nr. 1413, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "ELFA RECYCLING SHPK"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

Elfa Recycling sh.p.k.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**VENDIM**
**Nr. 3459, datë 9.7.2018**

**I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, "Për krijimin dhe mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve", i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 4, datë 7.11.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit juridik "Elfa Recycling sh.p.k.", protokolluar me nr. 4920 prot., datë 21.11.2017.

Komisioni:

Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë, rezultoi se vendim dënimi me pezullim të plotë të aktivitetit, nr. 4, datë 7.11.2017 nga ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, është marrë në përputhje me ligjin e posaçëm nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit".

VENDOSI:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 4, datë 7.11.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, për pezullimin plotësisht të aktivitetit dhe rrëzimin e ankimit të subjektit "Elfa Recycling" ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
NË DETYRË
**Armando Lamaj**

**KËRKESË**
**Nr. 1414, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "Z. FERIT KOKA"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

Z. Ferit Koka

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË
DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**VENDIM**
**Nr. 3462, datë 9.7.2018**

**I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 4.2.2015, "Për krijimin dhe mënyrën e organizmit dhe të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve", i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 695, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 15, datë 10.12.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit fizik "Ferit Koka" protokolluar me nr. 43 prot., datë 8.1.2018.

Komisioni:

Sa më sipër, nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët, arsyetojmë se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me germën "rr", të pikës 1, të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, "Për pyjet dhe shërbimin pyjor".

Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative të marrë nga ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë,

VENDOSI:

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 15, datë 10.12.2017, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 10.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit "Ferit Koka" ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
NË DETYRË
**Armando Lamaj**

**KËRKESË**
**Nr. 1415, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "1. ALBANO HYSENAJ NR. NIPT L52125099H"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. Albano Hysenaj nr. NIPT L52125099 H

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

**Nr. Serial:** 0001830 Datë: 06/07/2018

**PROÇES - VERBALI I INSPEKTIMIT**

Në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 103, datë 04.02.2015 "Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave", të ndryshuar, në kontrollin e ushtruar në subjektin:

Albano Hysenaj

**NIPT:** L52125099H

**Aktiviteti dhe adresa e subjektit:** [illegible]

në prani të: Albano Hysenaj, me detyrë Administrator

Konstatova: Subjekti është mbajtës i një leje administrative: **Po→** ☐ **Jo→** ☐ ;

Tipi i Lejes Mjedisore ______, Nr. Identifikimit ______, datë ___/___/______ .

PËRSHKRIMI, GJETJET DHE SHKELJET ADMINISTRATIVE:

[illegible]

| **Personi përgjegjës i kontrolluar** | **Specialisti** | **Inspektori i ISHMPU** |
|---|---|---|
| Albano Hysenaj (Emër, mbiemër, firmë) | (Emër, mbiemër, firmë) | (Emër, mbiemër, firmë) |

- Akti inspektimit mbahet në 4 (katër) kopje dhe sipas qëllimit të inspektimit përdoret:

1. Për kontrollin e përputhshmërisë. ☐
2. Për verifikimin e zbatimit së detyrave të lëna. ☐
3. Për inspektim të rastësishëm. ☐
4. Për rast incidenti ose aksidenti. ☐

- Për përshkrime të detajuara, aktit të inspektimit i bashkëlidhet një aneks shtesë A-4, si pjesë e tij.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

**Nr. Serial:** 0000290

## VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

**Nr.** 5, **datë** 12.07.2018

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "Albano Hysenaj", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës 1/a, të nenit 24, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0001830, datë 06/07/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

**1.** Të dënoj me **Gjobë** në vlerën : 300 000 **lekë** ( Treqind mijë lekë )

**2.** Të dënoj me **" Paralajmërim "**, si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

**3.** Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: Deri në pajisje me Leje Mjedisi

**4.** Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme: ……………………

……………………

……………………

**5.** Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi ________, datë ___/___/_____

**6.** Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ___.___.____

**7.** Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën ………… lekë (……………………)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

**INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU**

1. Skejdi Ahmetaj; ID ________; ( )
2. Dropo Mehmetaj; ID ________; ( )
3. Gezim Kuci; ID ________; ( )

( Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi )

**KËRKESË**
**Nr. 1416, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "1. A.K. SHPK"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. A.K sh.p.k.

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**NJOFTIM**
**Nr. 813, datë 1.6.2018**

**PËR PEZULLIM TË AKTIVITETIT A.K. SHPK (Ndërtim kompleks godina banimi dhe shërbimesh) Rr. Andrea Kushe, Parku 1 km, Nj. A nr. 7, Qarku Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", ju njoftojmë për sa vijon:

Nisur nga autorizimi i inspektimit nr. 663 prot., datë 18.5.2018 u mbajt procesverbal inspektimi me nr. serial 0000264, datë 19.5.2018 në aktivitetin e subjektit "A.K. sh.p.k.", me NIPT: J82226002M u konstatua se ka shkelje të kërkesave ligjore sipas legjislacionit të sipërcituar.

Nga kontrolli i kryer u konstatua se subjekti nuk disponon kontratë me subjekt të licensuar për transportin e mbetjeve inerte dhe venddepozitimin e miratuar.

Referuar aktmiratimit të VNM-së paraprake nr. 1886 prot., datë 1.8.2016 nr. identifikimi 43, vendimi 42 që disponon subjekti, po kryen punime për ndërtimin e objektit "Godinë banimi dhe shërbimesh" jo në përputhje me ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", duke mos qenë i pajisur me leje mjedisore për stacionim të mbetjeve inerte ose venddepozitim të përhershëm si dhe pa licencën përkatëse III.2.B, "Për transportin e mbetjeve".

Nga gjetjet e sipërcituara dhe duke vlerësuar situatën reale, rezultojnë këto problematika:

1. Ndikim të lartë në peizazh.
2. Ndotje të tokës bujqësore.
3. Zënie të parcelave në fondin pyjor ose kullosor.
4. Dëmtimin e florës dhe faunës.
5. Ngushtim dhe deformim të shtretërve të lumenjve, ku si pasojë sjellin përmbytje në kohë reshjesh.
6. Ndotje të rrugëve të qytetit nga aktiviteti lëvizës i makinerive të tonazhit të rëndë jashtë kushteve.
7. Ndotje të ajrit nga pluhurat dhe tymrat.
8. Ndotja nga zhurmat.

Duke ju referuar nenit 66, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", me qëllim parandalimin e ndotjes tej normave të lejuara dhe ndotjes potenciale të mjedisit, subjekti "A.K. sh.p.k." duhet të pezullojë plotësisht aktivitetin deri në:

1. Pajisjen me licencë III.2.B, "Për transportin e mbetjeve. Të mjeteve që do të kryejnë transportin e mbetjeve inerte, dherave sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015, "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
2. Pajisjen me njërën prej:

- Leje mjedisore, "Për stacion transferimi të mbetjeve" për qëllim rehabilitimi;

- Aktmiratim të VNM-së paraprake për venddepozitim të mbetjeve inerte;

- Kontratë me landfillimin për mbetje inerte.

3. Paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar sipas pikave 1 dhe 2 pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë.

Heqja e masës së pezullimit të aktivitetit për subjektin "A.K. sh.p.k." do të bëhet pas realizimin të detyrave të lëna.

KRYEINSPEKTOR
I NGARKUAR NË DETYRË
ISHMPUT, DEGA RAJONALE TIRANË
**Evisjon Salku**

**KËRKESË**
**Nr. 1417, datë 16.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "1. N.E.A-08 nr. NIPT K8181801 N"**

ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin administrativ përfundimtar të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Largimi i subjektit nga ajo adresë, apo adresë jo e saktë".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Dega Rajonale Tiranë, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

1. N.E.A-08 nr. NIPT K8181801 N

KRYEINSPEKTOR I NGARKUAR NË
DETYRË ISHMPUT, DEGA TIRANË
**Evisjon Salku**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**
**INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE**

**Nr. Serial:** 0000293

## VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

**Nr.** 8, **datë** 26.07.2018

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "N.E.A - 08", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës III.b.1, të nenit 49, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011, "Për Lejet e Mjedisit, i ndryshuar", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0001833, datë 10/07/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

1. Të dënoj me **Gjobë** në vlerën : 300 000 **lekë** ( Tre qind mijë lekë )
2. Të dënoj me " **Paralajmërim** ", si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

3. Të pezullojë pjesërisht ose plotësisht aktivitetin: ..........
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme: ..........
5. Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi ______, datë ___/___/____
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ___.___.____
7. Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën .......... lekë (..........)

**Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.**

**INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU**

1. Kejdi Ahmetaj; ID ______; ( )
2. Rrapo Mehmetaj; ID ______; ( )
3. ______; ID ______; ( )

( Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi )

**KËRKESË**
**Nr. 4270, datë 17.8.2018**

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV, NDAJ SUBJEKTIT "FRENKI" SHPK**

ISHMPUT-ja, Qendër, megjithëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin e dënimit nr. 5, datë 8.8.2018, të Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë duke u konfirmuar nga shërbimi postar "Adresë e panjohur".

Sa më sipër, ISHMPUT-ja, Qendër, bën njoftimin publik të vendimit të dënimit administrativ respektivisht për subjektin si më poshtë:

"Frenki" sh.p.k.

KRYEINSPEKTOR I KOMANDUAR
NË DETYRË
**Armando Lamaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE

Nr. Serial: 0000500

**VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT**
**Nr. 5, datë 08.08.2018**

Inspektorët e ISHMPU-së, pas ushtrimit të kontrollit mbi veprimtarinë e personit fizik/juridik, "FRENKI Shpk, Nipt: K22127003R", në mbështetje të nenit 46 e vijim, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë" dhe në zbatim të pikës II/a, të nenit 29, të ligjit nr. 10448 datë 14.7.2011, "Për lejet e Mjedisit (i ndryshuar)", referuar shkeljeve të pasqyruara në Proces - verbalin e inspektimit me Nr. Serie 0001717, datë 20/7/2018, të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative:

**VENDOSA:**

1. Të dënoj me **Gjobë** në vlerën : 500.000 lekë ( pesqind mije lek )
2. Të dënoj me **" Paralajmërim "**, si dënim administrativ kryesor.

Një nga dy dënimet kryesore të mësipërme, si dhe një ose disa nga dënimet plotësuese të mëposhtëme:

3. Të pezullojë ~~pjesërisht ose~~ plotësisht aktivitetin: deri në pajisje me leje Mjedisore
4. Të sekuestrojë pajisjet, mjetet dhe lëndët e mëposhtëme: ___ // ___
5. Të propozojë revokimin e lejes me Nr. Identifikimi ______, datë ___/___/___
6. Të korrigjojë shkeljet e konstatuara dhe t'i raportojë strukturës urdhëruese brenda datës ___.___.___
7. Të paguajë shpenzimet e analizave të mostrave në vlerën ______ lekë (______)

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim drejtuar Komisionit të Ankimit të ISHMPU, brënda 30 ditëve nga marrja e njoftimit. Ky vendimi mbahet në katër kopje.

**INSPEKTORËT E AUTORIZUAR TË ISHMPU**

1. Gentri Haderaj; ID 03000020011; ( [nënshkrim] )
2. Dritan Seferaj; ID 03000020004; ( [nënshkrim] )
3. ______; ID ______; ( )

( Emër, mbiemër, ID, nënshkrimi )

[Vula: REPUBLIKA E SHQIPËRISË – MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT – INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE DHE UJËRAVE – ISHMPU]

**KËRKESË**
**Nr. 10595/1, datë 20.8.2018**

## FTESË PËR OFERTË PËR PROCESIN KONKURRUES "PËR PËRZGJEDHJEN E PROJEKTIT QË DO TË PËRFITOJË MASAT MBËSHTETËSE PËR NDËRTIMIN E IMPIANTIT FOTOVOLTAIK NË ZONËN E AKËRNISË (VLORË)

Bazuar në vendimin nr. 349, datë 12.6.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e masave mbështetëse për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të diellit dhe të erës, si dhe të procedurave për përzgjedhjen e projekteve për përfitimin e tyre", Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ka hapur procesin konkurrues për përzgjedhjen e ofertuesit për zhvillimin e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik, në zonën e Akërnisë (Vlorë).

**1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktues**

Emri: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Adresa: rruga "Abdi Toptani", nr. 8, Tiranë

Tel./fax: +355 4 2222245

E-mail: sekretaria@infrastruktura.gov.al

Faqja e internetit: www.infrastruktura.gov.al

**2. Emri dhe adresa e personit të kontaktit**

Emri: **Enea Karakaçi**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Drejtor i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Tel.: +355 4 2222245

E-mail: enea.karakaci@infrastruktura.gov.al

Cc: Ervin Duraj

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Specialist, Drejtoria e Partneritetit Publik Privat në Fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë

Tel.: +355 4 2222245

E-mail: ervin.duraj@infrastruktura.gov.al

**3. Objekti i procesit konkurrues:** përzgjedhja e projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike me kapacitet gjenerues të instaluar 50 mw, si pjesë e masave mbështetëse, në zonën e Akërnisë (Vlorë) dhe ndërtimin e kapaciteteve të tjera shtesë nga 20 mw deri në 50 mw, të cilat nuk do të jenë pjesë e masave mbështetëse.

**4. Lloji i procesit konkurrues:** i hapur.

**5. Vendndodhja e objektit të procesit konkurrues:** Bashkia Vlorë, zona Akërni, në zonën kadastrale ZK 1007, Vlorë.

6. **Kohëzgjatja e marrëveshjes së projektit:** 30 vjet, me të drejtë përsëritjeje.

**7. Kohëzgjatja e marrëveshjes së blerjes së energjisë:** si pjesë e masave mbështetëse, marrëveshja e blerjes së energjisë do të nënshkruhet për kapacitetin 50 mw për një kohëzgjatje 15 vjet.

**8. Afati kohor për ekzekutimin e punimeve:** 18 muaj nga data efektive, e cila nënkupton datën e nënshkrimit të marrëveshjes së projektit.

**9. Afati kohor për dorëzimin e ofertës:** jo më vonë se data 17.9.2018, ora 12:00. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë do të lëshojë konfirmimin e marrjes së ofertës, me datën dhe orën e pranimit. Ofertat e marra pas afatit përfundimtar nuk do të merren parasysh. Ato do t'i kthehen ofertuesit pa u hapur.

**10. Afati kohor për hapjen e ofertave:** 17.9.2018, ora 12:00.

**11. Periudha e vlefshmërisë së ofertave e shprehur në ditë:** 150 ditë (njëqind e pesëdhjetë) nga afati i përcaktuar për dorëzimin e ofertave.

**12. Pagesa e tarifës së pjesëmarrjes në procesin konkurrues:** çdo shoqëri ose bashkim shoqërish ofertuese, të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në procesin konkurrues duhet të paguajnë paraprakisht tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues. Subjektet e interesuara si më sipër, janë të detyruara të ofrojnë dëshmi mbi pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në procesin konkurrues, duke deklaruar në emër të cilit subjekt është paguar tarifa. Nëse subjekti i interesuar vepron si përfaqësues i autorizuar i një shoqërie ose bashkimi shoqërish, ata janë të detyruar të paraqesin autorizimin e përfaqësimit të shoqërisë apo bashkimit të shoqërive.

Autoriteti kontraktor mban regjistrin e personave/subjekteve që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes dhe vetëm atyre iu vë në dispozicion, një kopje të dokumenteve të procesit konkurrues, sipas kërkesës së tyre në gjuhën shqipe ose angleze. Tarifa e pjesëmarrjes

në procesin konkurrues është 2.000 euro (dy mijë euro). Pagesa do të bëhet në llogarinë e autoritetit kontraktues, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, me të dhënat si më poshtë:

**Emri i institucionit përfitues: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë**

**Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar**

**Kodi i institucionit: 1006001**

**Kodi i degës së thesarit ku vepron: 3535**

**Blerje dokumentesh për tender: 7113013**

**Me përshkrimin:** Tarifë për pjesëmarrjen në procesin konkurrues, me objekt për "Përzgjedhjen e Projektit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike me kapacitet gjenerues të instaluar 50 mw, si pjesë e masave mbështetëse, në zonën e Akërnisë (Vlorë)".

Tarifa e pjesëmarrjes në procesit konkurrues është e pakthyeshme.

Vetëm ofertuesit që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes në procesit konkurrues kanë të drejtë të marrin pjesë në këtë procedurë.

Dokumentet e procesit konkurrues mund të tërhiqen nga subjektet e sipërcituara, duke filluar nga data 6.8.2018, çdo ditë të javës, me përjashtim të ditës së shtunë dhe të diel, nga ora 9:00 deri në orën 14:00 në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë: rruga "Abdi Toptani", nr. 8, Tiranë, Shqipëri, tel. +355 4 2222245. Personi përgjegjës për dhënien e dokumenteve të procesit konkurrues: Ervin Duraj; e-mail: ervin.duraj@infrastruktura.gov.al

**13. Gjuha për paraqitjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:** ofertat duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe ose në anglisht. Nëse dokumentacioni është dorëzuar në gjuhën angleze, ofertuesi është i detyruar, gjithashtu, të dorëzojë një përkthim në gjuhën shqipe. Në rast të mosmarrëveshjes, përkthimi në gjuhën shqipe do të përdoret për të interpretuar informacionet dhe paqartësitë.

**14. Të dhëna lidhur me vendndodhjen e projektit:** zona ku do të zhvillohet projekti është zona e Akërnisë, Bashkia Vlorë, ZK 1007. Zona e Akërnisë është një nga zonat më të favorshme me rrezatim më të lartë diellor dhe eficiencë më të lartë të prodhimit të energjisë elektrike nga impiantet diellore, e cila ka një potencial të energjisë diellore prej më shumë se 1600 kwh/m$^2$. Koordinatat e zonës së identifikuar janë të specifikuara në dokumentet e procesit konkurrues.

**15. Lidhja me rrjetin e transmetimit:** Lidhja me rrjetin e transmetimit e impiantit fotovoltaik me rrjetin 110 kV të transmetimit.

Skema e lidhjes me rrjetin dhe distancat përkatëse mund të ndryshojnë në varësi të zonës përfundimtare të ndërtimit të parkut fotovoltaik, të pozicionit ku do të ndërtohet nënstacioni ngritës 110/TM kV i parkut fotovoltaik në zonë, si dhe të gjurmës së linjës deri në pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit.

**16. Kostot infrastrukturore:** Çdo kosto infrastrukturore për aksesin e projektit dhe lidhjen e projektit me rrjetin e transmetimit, përballohet nga ofertuesi.

**17. Sigurimi i ofertës:** Ofertuesit duhet të paraqesin sigurimin e ofertës në vlerën 200.000 euro.

**18. Pyetjet e paraofertës:** Ofertuesit e mundshëm mund të paraqesin pyetje në lidhje me dokumentet e procesit konkurrues, me *e-mail,* në adresën e caktuar të personit të kontaktit. Të gjitha pyetjet në lidhje me DPK-në duhet të dorëzohen deri në orën 15:00 të orës standarde të Evropës Qendrore, më 24 gusht 2018.

**19. Takimi paraprak dhe vizita në terren:** autoriteti kontraktor do të organizojë një takim të paraofertës dhe një vizitë në terren për të gjithë ofertuesit që kanë bërë pagesën e pjesëmarrjes në procedurën konkurruese. Koha dhe vendi i mbajtjes së takimit paraprak do të jenë:

Koha: 27 gusht 2018, ora 10:00.

Vendi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Secili ofertues do të lejohet të sjellë maksimumi 3 persona në takimin e paraofertës dhe në vizitën në terren. Të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve do të mbajnë autorizimin e duhur për të marrë pjesë në takimin paraofertës dhe vizitën në terren në emër të ofertuesve. Gjatë takimit të paraofertës, përfaqësuesit e autoritetit kontraktor do të sqarojnë ofertuesit e mundshëm lidhur me aspekte të ndryshme të ofertës.

Një vizitë në terren për ofertuesit, gjithashtu, do të përfshihet në takimin e paraofertës.

**20. Përgjigjet e pyetjeve të paraofertës:** autoriteti Kontraktor do të japë përgjigje brenda

datës 31.8.2018, për të gjitha pyetjet e paraqitura nga ofertuesit që kanë paguar tarifën e pjesëmarrjes në procesin konkurrues.

**21. Kriteret e vlerësimit të ofertave:** kriteret e vlerësimit të ofertave, janë:

1. Kriteret e parakualifikimit, që provojnë përmbushjen e kritereve ligjore dhe të besueshmërisë të ofertuesve;
2. Kriteret teknike (70 pikë), që provojnë përmbushjen e kapaciteteve teknike dhe financiare;
3. Kriteri financiar (30 pikë), i cili përfshin kuotimin e ofertuesit për një tarifë fikse 15-vjeçare në euro/mwh si pjesë e masave mbështetëse dhe angazhimin për ndërtimin e kapaciteteve të tjera shtesë, nga 20 mw deri në 50 mw, të cilat nuk do të jenë pjesë e masave mbështetëse.

**22. Zhvillimi i procesit:** ofertuesit do të dorëzojnë dokumentet e kërkuara në DPK, në një zarf të mbyllur (ose kuti të mbyllur) të sigluar nga përfaqësuesi i ofertuesit dhe me vulën e shoqërisë ofertuese. Ky zarf do të ketë në brendësi 3 zarfe:

1. Dokumentet e parakualifikimit (një zarf);
2. Dokumentet teknike (një zarf);
3. Dokumentet financiare (një zarf).

**23. Nënshkrimi i kontratës:** në përfundim autoriteti kontraktor negocion dhe nënshkruan kontratën me ofertuesin që ka paraqitur propozimin më të mirë të vlerësuar.

**Data e njoftimit:** 6.8.2018.

ZËVENDËSMINISTRI I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
**Dorina Çinari**

**NJOFTIM**
**Nr. 717, datë 23.8.2018**

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE**
**DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE**

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, kapitulli III, shpall për shitje me VAM fillestar, si më poshtë:

**1. Në administrim të Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja | Vlerat (në lekë) | | | Sipërfaqja e përgjithshme ($m^2$) | Sipërfaqja nën objekt ($m^2$) | Zhvillimi i ankandit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli) | Mjetet kryesore | Trualli | | | Data | Ora | Vendi |
| 1 | "Objekte të Agjencisë Maqellarë, të Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit Mat" | Maqellarë, Dibër | 43 744 160 | 43 591 140 | 153 020 | 1 093 | 1 093 | 18.9.2018 | 10:00 | DDPP |

**2. Në administrim të Ministrisë së Brendshme**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja | Vlerat (në lekë) | | | Sipërfaqja e përgjithshme ($m^2$) | Sipërfaqja nën objekt ($m^2$) | Zhvillimi i ankandit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli) | Mjetet kryesore | Trualli | | | Data | Ora | Vendi |
| 1 | "Posta kufitare" | Trebisht, Dibër | 4 309 814 | 3 945 494 | 364 320 | 3 312 | 370 | 18.09.2018 | 11:00 | DDPP |

**3. Në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja | Vlerat (në lekë) | | | Sipërfaqja e përgjithshme ($m^2$) | Sipërfaqja nën objekt ($m^2$) | Zhvillimi i ankandit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli) | Mjetet kryesore | Trualli | | | Data | Ora | Vendi |
| 1 | Objekti me nr. 3 dhe nr. 7, komponentë të pronës nr. 1007 me emërtim "Nënreparti Ushtarak nr. 1503" | Gjeroven, Berat | 2 749 673 | 2 250 329 | 499 344 | 2 424 | 751.5 | 18.09.2018 | 12:00 | DDPP |

**4. Në administrim të Ndërmarrjes Industriale nr. 1**

| Nr. | Emërtimi i objektit | Vendndodhja | Vlerat (në lekë) | | | Sipërfaqja e përgjithshme (m²) | Sipërfaqja nën objekt (m²) | Zhvillimi i ankandit | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli) | Mjetet kryesore | Trualli | | | Data | Ora | Vendi |
| 1 | "Magazinë" e ish-Ndërmarrjes së Prodhim-Veshjeve nr. 1 | Tiranë | 19 285 556 | 6 365 931 | 12 919 625 | 419.7 | 265.8 | 18.9.2018 | 09:00 | DDPP |

**Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand** duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

**Shënim**. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

**Subjekti i shpronësuar i truallit** mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20% të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj., nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë www.financa.gov.al

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE**
**DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE**

Në zbatim të VKM-së nr. 926, datë 29.12.2014, "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", i ndryshuar, shpall për shitje si më poshtë:

AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

| **Nr.** | **Emertimi i objektit** | **Vendndodhja** | **Vlerat (në lekë)** | | | **Sipërfaqja e përgjithshme (m²)** | **Sipërfaqja nën objekt (m²)** | **Zhvillimi i ankandit** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | **Vlera fillestare e ankandit (mjete kryesore + trualli)** | **Mjetet kryesore (ndërtesa)** | **Trualli** | | | **Data** | **Ora** | **Vendi** |
| 1. | Tokë arë, ZK 3866, nr. Pasurie 193/8 | Yzberisht, Tiranë | 965 250 | | | 1485 | | 18.9.2018 | 13:00 | DDPP |

**Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand** duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
2. **Mandatpagesën** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit në lekë.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

**Shënim**. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit te shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë www.financa.gov.al.

**KËRKESË**
**Nr. 897/11, datë 23.8.2018**

**PËR SHPREHJE INTERESI**
**SHËRBIME KONSULENCE**

**"Për hartimin e metodologjive dhe trajnimin e stafit për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një profili të rrezikut (përfshirë procedurat ndërkontrolluese) për NE-në"**
**Numër reference: SAMP/CS/CQ/07–2016**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)*
*Hua No.: 8141- AL*
*Nr. i identifikimit të Projektit. P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale ("Shërbim") përfshin **"Hartimi i metodologjive dhe trajnimi i stafit për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e një profili të rrezikut (përfshirë procedurat ndërkontrolluese) për NE-në".**

Qëllimi i kësaj detyre është të hartojë dhe të zbatojë një sistem hetimi me bazë rrezikun me mbështetjen e SMI-së për NE-në, të integrojë masat korrigjuese të sistemit për mashtrim dhe gabim dhe të përgatisë udhëzimet operacionale që përshkruajnë një sistem referimi për rastet e gabimit ose dyshimit për mashtrim dhe korrupsion, me kanale të qarta raportimi për stafin dhe publikun e gjerë dhe të ofrojë trajnimin e inspektorëve socialë për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe azhurnimin e profilit të rrezikut për NE-në.

Në këtë kontekst, një firmë konsulente do të rekrutohet për të ndihmuar MHSP-në për të hartuar dhe zbatuar një sistem hetimi me bazë rrezikun me mbështetjen e SMI-së për NE-në me qëllim rritjen e efikasitetit dhe saktësisë së zbulimit të mashtrimit dhe gabimeve.

Kompania do të jetë përgjegjës, për:

- Analizën e sistemeve të zgjeruara të informacionit të automatizuar të NE-së, përfshi përdorimin e mjeteve të profilizimit me bazë rreziku në formulimin e kornizës dhe politikave. Përfshirjen në kuadrin ligjor të sanksioneve të forcuara me mjete të qarta hetimi, sanksioneve dhe dispozitave për rastet e mashtrimit dhe gabimit, si dhe për pasojat e llojeve të ndryshme të mashtrimit dhe gabimit.
- Përgatitjen dhe zhvillimin e kuadrit ligjor përkatës i nevojshëm për përdorimin në inspektim të mjeteve të profilit të bazuar në rrezik, duke përfshirë shënimet shpjeguese, si dhe tabelën e përputhshmërisë së akteve të hartuara me *acquis communautaire* nëse është e nevojshme.
- Zhvillimin e një mjet profilizimi me bazë risku për inspektimet sociale të rasteve të NE-së.
- Aplikimin dhe testimin e mjetit për të vërtetuar saktësinë e tij në identifikimin e rasteve me rrezik të lartë;
- Përgatitjen e udhëzimeve operacionale që përshkruajnë si të aplikojnë mjetin e profilizuar me bazë rreziku dhe një sistem referimi për rastet e gabimit ose dyshimin e mashtrimit dhe korrupsionit, me kanale të qarta raportimi për stafin dhe publikun e gjerë;
- Zhvillimin e moduleve të nevojshme për ofrimin e trajnimeve për stafin e dedikuar për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe përditësimin e profilit të rrezikut për NE-në;
- Zhvillimin e modelit të raporteve të profilizimit të rrezikut që duhet të gjenerojë sistemi i menaxhimit të informacionit SMI;
- Ofrimin e trajnimit të inspektorëve socialë për metodologjitë për ndërtimin, mbajtjen dhe përditësimin e profilit të rrezikut për NE-në.

Ky shërbim do të kërkojë një firmë konsulente me njohuri solide të praktikave më të mira lokale në sektorin social. Konsulenti duhet të dëshmojë kryerjen me sukses të shërbimeve të ngjashme.

Konsulenti duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, me përvojë dhe njohuri të konsiderueshme për mbrojtjen sociale, veçanërisht për programin e NE-së dhe njohuri bazë solide të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi.

Konsulenti pritet të ketë përvojë në hartimin dhe zbatimin e procesit të inspektimit të programeve të sektorit social brenda 5 viteve të fundit. Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë së paku nga një ekspert social, ekspert statistikash dhe ekspert ligjor.

Kompania duhet të demonstrojë ekspertizë dhe aftësi në fushat e mëposhtme:

• Vlerësime në fushën sociale;

• Inspektimi në fushën sociale;
• Çështjet operative dhe çështjet administrative të asistencës sociale;
• Forcimi organizativ dhe institucional;
• Komunikim.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton kompanitë konsulente ("Konsulente") të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit, janë:

| Kriteret e shortlistimit | Pikët |
|---|---|
| Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit | 30 pikë |
| Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit | 20 pikë |
| Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor | 20 pikë |
| Eksperienca specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor | 30 pikë |
| **Totali** | **100 pikë** |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së dhe grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* ("Udhëzuesi i konsulencës ") – version i janarit të 2011-s.

Shërbimi do të kryhet nga një kompani konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore*: Përzgjedhja e punësimi i konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011)* (edition of 2011).

Shërbimi pritet të fillojë në shtator 2018 dhe të përfundojë në dhjetor 2018.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **7 shtator 2018.**

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**
**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**
**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
**Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, ALBANIA**
**Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli**
**e-mail:** samp.papadhopulli@gmail.com

**KËRKESË**
**Nr. 897/12, datë 23.8.2018**

**PËR SHPREHJE INTERESI**
**SHËRBIME KONSULENCE**

**"Për sondazhin e familjeve për vlerësimin e ndikimeve të reformës së NE-së"**
**Numër reference: SAMP/CS/CQ/13-2016**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)*
*Hua No.: 8141- AL*
*Nr. i identifikimit të Projektit. P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale ("Shërbim") përfshin **"Sondazh i familjeve për vlerësimin e ndikimeve të reformës së NE-së".**

Objektivi i përgjithshëm i kësaj konsulence është mbledhja e të dhënave nga zonat e përzgjedhura për të vlerësuar gjendjen aktuale në këto zona pas zbatimit të ndryshimeve në sistemin e asistencës sociale (p.sh. ndryshimet në kriteret e pranueshmërisë etj.). Kjo do të lejojë monitorimin dhe matjen e ndikimeve afatshkurtra të ndryshimeve, si dhe ndikimin e programeve të asistencës sociale në tërësi, duke vlerësuar rezultatet e dëshiruara të programit për barazi dhe efikasitet.

Objektivat specifikë të kësaj detyre janë mbledhja e të dhënave për një studim familjar mbarëkombëtar për të vlerësuar ndikimet e reformës së NE-së, bazuar në mostrat e nxjerrë dhe metodologjinë që do të projektohet paraprakisht nga konsulenti ndërkombëtar, i cili do të ofrojë asistencë teknike për dizenjimin e vlerësimit të ndikimit (përfshirë marrjen e mostrave), analizën e të dhënave të sondazhit për vlerësimin e impaktit në ekonomitë familjare.

Në bashkëpunim të ngushtë me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Drejtorisë së Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (DPZHSHMSDP) brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (që është agjencia zbatuese për SAMP-in) dhe Bankës Botërore, kompania konsulente do të jetë përgjegjëse për zbatimin e metodologjisë së dizenjuar për mbledhjen e të dhënave për vlerësimin e ndikimit në familje, për të matur indikatorët e projektit për mbrojtjen sociale; përfshi grumbullimin sasior dhe cilësor të të dhënave, marrjen e mostrave etj.

Kompania konsulente duhet të ketë 8 vjet përvojë të dokumentuar në sondazhe ose studime të ngjashme. Konsulenti duhet të ketë përvojë të mëparshme në hartimin dhe kryerjen e studimit; njohuri të kontekstit rajonal dhe institucional; kompetencë teknike në sektorin social; aftësi të menaxhimit të procesit etj. Firma duhet të paraqesë dy/tre shembuj të punës nga përvoja e saj e mëparshme.

Kompania konsulente duhet të provojë se ka kryer me sukses detyra të ngjashme. Ajo duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, i cili ka përvojë dhe njohuri të konsiderueshme në sondazhet e mbrojtjes/asistencës sociale dhe një njohje të mirë të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi.

Konsulenti do të caktojë një drejtues të ekipit për këtë detyrë, i cili do të jetë personi i kontaktit në emër të konsulentit. Kompania duhet të jetë në gjendje të mobilizojë intervistues të kualifikuar, personel për hedhjen e të dhënave, kontrollorë dhe duhet të ketë kapacitetet logjistike për të kryer sondazhin brenda kohës së studimit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjitha kompanitë konsulente lokale ("Konsulente") të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit, janë:

| **Kriteret e shortlistimit** | **Pikët** |
|---|---|
| Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit | 10 pikë |
| Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit | 10 pikë |
| Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor | 20 pikë |
| Eksperienca specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor | 50 pikë |
| Numri i viteve pranë firmës të stafit kryesor | 10 pikë |
| **Totali** | **100 pikë** |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së dhe grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* ("Udhëzuesi i konsulencës ") – version i janarit të 2011-s.

Shërbimi do të kryhet nga një kompani konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore*: Përzgjedhja e punësimi i konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011).*

Shërbimi pritet të fillojë në shtator 2018 dhe të përfundojë në dhjetor 2018. Kompania lokale do të kontraktohet sipas një kontrate *lump-sum.*

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit

zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **7 shtator 2018.**

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**
**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**
**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
**Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, ALBANIA**
**Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli**
**e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com**

**KËRKESË**
**Nr. 897/13, datë 23.8.2018**

**PËR SHPREHJE INTERESI SHËRBIME KONSULENCE**

**"Për përditësimin e moduleve të trajnimit dhe trajnimin e stafit të vlerësimit të PAK, mjekëve specialistë dhe mjekëve të familjes, administratorëve socialë të Bashkisë Tiranë në zbatimin e reformave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar"**
**Numër reference: SAMP/CS/CQ/01-2018-A**

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)*
*Hua No.: 8141- AL*
*Nr. i identifikimit të Projektit. P122233*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës lokale ("Shërbim") përfshin **"Përditësimi i moduleve të trajnimit dhe trajnimi i stafit të vlerësimit të PAK, mjekëve specialistë dhe mjekëve të familjes, administratorëve socialë të Bashkisë Tiranë në zbatimin e reformave të vlerësimit të aftësisë së kufizuar".**

Qëllimi i kësaj konsulence është të asistojë MSHMS (Departamenti i Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale) në përditësimin e moduleve ekzistuese të trajnimit dhe trajnimin e mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë dhe administratorët socialë të të gjitha njësive administrative (me përjashtim të njësive administrative nr. 6 dhe nr. 7), të Bashkisë së Tiranës, për zbatimin e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Detyrat e konsulentit përfshijnë si më poshtë:

1. Përditësimi i programit të kursit të trajnimit dhe i materialeve për trajnim për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar dhe rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë stafit që përfshihet në rrjetin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në të gjitha njësitë administrative të Tiranës.
2. Kryerja e trajnimit të rrjetit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në të gjitha njësitë administrative të Tiranës.
3. Përgatitja e materialeve të trajnimit, duke përfshirë shpërndarjen e moduleve të trajnimit dhe materialeve të tjera të shkruara, për të gjithë pjesëmarrësit, për përdorim gjatë trajnimit dhe për referim të mëtejshëm në punën e tyre të përditshme si burime për zhvillimin e tyre profesional.

Firma konsulente duhet të ketë eksperiencë minimale prej 7 vitesh në zhvillimin dhe ofrimin e moduleve të trajnimit në sektorin social. Përvoja në kryerjen e trajnimit për nëpunësit publikë do të konsiderohet si një avantazh.

Konsulenti duhet të ketë eksperiencë në kryerjen e detyrave të ngjashme. Konsulenti duhet të ketë të paktën 7 vjet në biznes. Duhet të ketë një ekip shumëdisiplinor, i cili ka përvojë dhe njohuri të konsiderueshme për mbrojtjen sociale, veçanërisht me programin e asistencës për aftësinë e kufizuar dhe kuptimin e bazës solide të zhvillimit procedural, institucional dhe shoqëror në përgjithësi.

Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga një udhëheqës ekipi me njohuri shumë të mira për sistemin e mbrojtjes sociale, Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ICF etj. dhe së paku dy konsulentë/trajnerë me përvojë në mësimdhënie ose kryerjen e trajnimeve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit (EMP) fton të gjitha kompanitë konsulente lokale ("Konsulente") të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimit të kërkuar. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet.

Kriteret e shortlistimit, janë:

| Kriteret e shortlistimit | Pikët |
|---|---|
| Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit | 10 pikë |
| Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tri viteve të fundit | 20 pikë |
| Eksperienca e përgjithshme dhe kualifikimet e stafit kryesor | 10 pikë |
| Eksperienca specifike në fushën e shërbimit dhe kualifikimet e stafit kryesor | 50 pikë |
| Numri i viteve pranë firmës të stafit kryesor | 10 pikë |
| **Totali** | **100 pikë** |

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore, për: *Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga kredi të IBRD-së dhe hua të IDA-së dhe grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore* ("Udhëzuesi i konsulencës ") – version i janarit të 2011-s.

Shërbimi do të kryhet nga një kompani konsulente. Metoda e përzgjedhjes do të jetë kualifikimet e konsulentëve (CQ), në përputhje me procedurat e përcaktuara në udhëzuesit e Bankës Botërore*: Përzgjedhja e punësimi i konsulentëve të Bankës Botërore (botimi 2011).*

Shërbimi pritet të fillojë në shtator 2018 dhe të përfundojë në dhjetor 2018. Kompania lokale do të kontraktohet sipas një kontrate *lump-sum*.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00–14:00, të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi ose me e-mail) deri më **7 shtator 2018.**

**Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**
**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**
**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
**Rruga e Kavajës, AL-1001, Tirana, ALBANIA**
**Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli**
**e-mail:** samp.papadhopulli@gmail.com

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

**Tiranë, 2018**